



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**Lënda :** Raport mbi informacionin të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën Prill - Qershor 2019

**Drejtuar :** Mbledhjes Plenare

**Përgatiti :** Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale

Të nderuar anëtarë!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësiave për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efijencës, në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e gjykatave, bazuar nënenet 22, 37 të ligjit nr.98/2016, nënenet 61,71, 75, 82, 96 të ligjit nr.96/2016, nënenet 83, 89 të ligjit nr. 115/2016, ka miratuar vendimin nr. 25, dt 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”. Me vendimin nr.115, dt 09.07.2019, Këshilli ka miratuar edhe formularin tip sipas të cilit do të dërgohej ky informacion.

Bazuar në këtë vendim, nga ana e Kryetarëve të të gjithë gjykatave është dërguar pranë Këshillit ky informacion për periudhën Prill – Qershor 2019. Nga ana e specialistes, Zj. Aida Ndreu, është përgatitur memo, duke pasqyruar këtë informacion në mënyrë të përmbledhur. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pasi u njoh me këtë informacion dhe memon, paraqet para Këshillit një raportim përmbledhës, duke evidentuar problematikat dhe sugjerimet për zgjidhjen e tyre.

*a) Ngarkesa e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe çdo gjyqtar të saj, evidentimi i numrit të çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse, si dhe numri i çështjeve të zvarritura tej afateve të arsyeshme të përcaktuara në nenin 399/2 të K.Pr.Civile, respektivisht për secilën shkallë gjykimi.*

1. Në lidhje me këtë të dhënë, nga raportimet e sjella, u konstatua se një numër i konsiderueshem i gjykatave, konkretisht 31 nga 38 gjykata, i përcillnin statistikatat tërësisht gabim, pasi sipas formatit tip të miratuar nga KLGJ, të dhënat për çështjet e mbartura, të regjistruara, të gjykuara dhe ato në shqyrtim, nuk përputheshin. Për këtë është komunikuar nëpërmjet telefonit me të gjithë kancelarët e të gjitha gjykatave që kishin këto probleme, me qëllim shpjegimin më qartësisht të mënyrës së plotësimit të tyre, për të ridërguar edhe njëherë këto të dhëna nëse kishte mundësi, dhe që tremujorin pasardhës mos të përsëritej e njëjta situatë. Nga ky komunikim ka rezultuar se arsyeja e kësaj pasaktësie ka qenë moskuptimi nga ana e kancelarëve të të dhënave që duhet të dërgojnë, por edhe nga fakti që këto të dhëna nuk gjenerohen nga sistemi automatikisht, por bëhen manualisht.

Ndërkohë, nga këto 31 gjykata vetëm 5 prej tyre nuk kanë reaguar ose i kanë ridërguar gabim, e që janë konkretisht; Gjykata Administrative e Apelit Tiranë , Gjykata Administrative e Shkallës

së Parë Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

**Për sa më sipër propozohet :**

- 1 **Trajnim i kancelarëve për mënyrën e perpilimit të statistikave, ne lidhje me çfarë do të konsiderohet :**
  - Çeshtje të mbartura nga viti i mëparshëm;
  - Çështje të regjistruara të reja nga data 01 Janar;
  - Çështje të gjykuara dhe ;
  - Çeshtje në shqyrtim.
- 1 **Unifikim i mënyrës së regjistrimit manualisht të çështjeve në gjykata (regjistrat) deri në momentin implementimit të një sistemi elektronik të uniformizuar te menaxhimit të çështjeve.**
- 1 **Përfshirjen në statistika të çështjeve të pezulluara**

i Në lidhje me ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatë dhe çdo gjyqtar, konstatohet se Gjykatat japin informacion si më poshtë, **Cështje në gjykim : (ANEKS 1):**

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 128 çështje, në tremujorin e parë kjo ngarkese ka qene 121 ;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 72 çështje, në tremujorin e parë nuk ka raportim;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 99 çështje, për tremujorin e parë ka qenë 90 çështje penale dhe 90 çështje civile;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 84 çështje, në tremujorin e parë nuk ka raportim;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 115 çështje, në tremujorin e parë ka qenë 123 çështje;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 132 çështje, për tremujorin e parë ka qenë 123 çështje;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 117 çështje, për tremujorin e parë ka qenë 113 çështje;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 62 çështje, për tremujorin e parë ka qenë 70 çështje;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 122 çështje, për tremujorin e parë ka qenë 130 çështje;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 84 çështje, për tremujorin e parë ka qenë 96 çështje;
- **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin nuk ka raportim, ndërkohë që tremujorin parardhës ka pasur me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 179 çështje;**
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 93 çështje, por nuk ka raportim për tremujorin e parë;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 118, ngarkesa e tremujorit të parë ka qenë 117 çështje;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 46 çështje, por nuk ka raportim për tremujorin e parë;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 33 çështje, por nuk ka raportim për tremujorin e parë (per nje numer 3/gjyqtarësh);
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 63 çështje, por nuk ka raportim për tremujorin e parë (për një numër 2/gjyqtarësh);
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 122 çështje, ndërsa ngarkesa e 3/mujorit të parë ka qenë 93 çështje;

-- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 114 çështje, por nuk ka raportim për 3/mujorin e parë.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 111 çështje ndërsa ngarkesa e 3/mujorit paraardhës është raportuar 266 çështje;

-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 104 çështje, ndërkohë që ngarkesa e 3/mujorit paraardhës ka qenë 105 çështje, por nuk është paraqitur ngarkese me vete sipas seksionit;

--- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 81 çështje, por nuk ka raportim për 3/mujorin e parë( nr. i gjyqtarëve 2).

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 111 çështje, ndërsa ajo e tremujorit paraardhës ka qenë 98 çështje, por nuk është paraqitur ngarkese me vete sipas seksionit;

-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Renda me një ngarkese mesatare për gjyqtar prej 7 çështje, por nuk ka raportim për 3/mujorin e parë.

**-Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka nje tregues pothuajse te pashpjegueshem të shpërndarjes së ngarkesës midis gjykatave, konkretisht : Kryetarja e Gjykatës ka një ngarkese çështjesh në gjykim prej 65 çështje, ndërsa dy gjyqtarët e tjerë kanë mbi 5/fishin e saj (509 dhe 513 çështje) dhe gjyqtarja e transferuar ka 225 çështje;**

**-Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me nje ngarkese mesatare për gjyqtar 86 çështje, ndërsa ajo e tremujorit të parë ka qenë 404 çështje;**

**- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me nje ngarkese mesatare për gjyqtar 70 çështje, ndërsa ajo e tremujorit të parë mungon;**

**-- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me nje ngarkese mesatare për gjyqtar 945 çështje, këto janë çështjet e regjistruara ne total ne kete gjykatë ku ka vetem një gjyqtar në detyrë;**

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me nje ngarkese mesatare për gjyqtar prej 123 çështje, por ka diference te theksuar midis shperndarjes se çështjeve midis gjyqtareve ;

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me nje ngarkese mesatare për gjyqtar 78 çështje, ndërsa ajo e tremujorit të parë mungon;

**-Gjykata e Apelit Durrës me një ngarkese mesatare për gjyqtar/relator prej 272 çështje ;**

**- Gjykata e Apelit Korçe me një ngarkese mesatare për gjyqtar/relator prej 67 çështje ;**

**-Gjykata e Apelit Gjirokastrë me një ngarkese mesatare për gjyqtar/relator prej 50 çështje ;**

**-Gjykata e Apelit Shkodër me një ngarkese mesatare për gjyqtar/relator prej 150 çështje ;**

**- Gjykata e Apelit Vlorë me një ngarkese mesatare për gjyqtar/relator prej 193 çështje**

**- Gjykata e Apelit Tiranë raporton një ngarkese mesatare për gjyqtar/relator prej 400 çështje;**

**- Gjykata e Apelit për Krime të Rënda raporton një ngarkese mesatare për gjyqtar/relator prej 4 çështje;**

**-Gjykata e Apelit Administrativ paraqet dukshëm një diferencë të konsiderueshme të çështjeve që kanë në ngarkim gjyqtarët sipas tabelës së mëposhtme :**

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështje të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështje të regjistruara të reja (nga data 01 janar)	Nr. i çështjeve të gjykuara	Nr. i çështjeve në shqyrtim
1.	Kastriot Selita	170	108	100	<b>159</b>
2.	Alkelina Gazidede	704	209	185	712
3.	Altina Nasufi	864	210	199	916
4.	Amarildo Laçi	1329	207	200	1371

5.	Arjan Qafa	685	214	343	562
6.	Artur Malaj	1025	220	152	1094
7.	Bari Shyti	1270	210	195	1286
8.	Bernina Kondi	842	215	188	873
9.	Blerona Hasa	1374	212	195	<b>1399</b>
10.	Enkelejda Metaliaj	748	211	209	747
11.	Fjoralba Prifti	1455	214	219	<b>1451</b>
12.	Lindita Sinanaj	781	215	162	837
13.	Rilinda Selimi	970	201	153	1034
<b>Totali</b>		<b>12217</b>	<b>2646</b>	<b>2500</b>	<b>12441</b>

**Gjykata e Lartë raporton deri në dt. 30.06.2019 një backlog prej 32 106 çështje.**

Përsa i perket përmbajtjes së këtyre të dhënave, ashtu si dhe në tremujorin e parë, edhe në këtë tremujor, në *lidhje me ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatë dhe çdo gjyqtar*, konstatohet se :

**Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm :**

- i Përmet; Pukë; Mat; Korçe ngarkesa për gjyqtar është rreth 60 çështje;
- i Gjykatat e tjera të cilat kanë një numër gjyqtarësh në detyrë më pak se 5/gjyqtarë, ngarkesa e gjyqtareve është mbi 120 çështje në shqyrtim.
- i Gjykata e mëdha si Shkodër, Tiranë, Vlorë, Fier, Sarandë, Lushnje, Krujë ngarkesa është pothuajse e njëjtë;
- i Gjykata e Gjirokastrës dhe Pogradecit, raportojnë ngarkesa më të madhe për gjyqtar këtë 3/mujor të dytë.

**Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të posaçëm :**

- i Korçe, Gjirokastrë dhe Tiranë kanë ngarkesa afërsisht të njëjtë;
- i Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka diferenca të pashpjegueshme, prandaj duhet t'i kërkohet Kryetares së Gjykatës, në kushtet kur nuk është ngritur ILD ecila mbikqyr menyrën e ndarjes së çështjeve me short, informacon në lidhje me arsyet pse janë këto të dhëna;
- i Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhet ndërhyrë në menyrë urgjente për plotësimin e trupës gjyqësore;

**Gjykatat e Apeleve të juridiksionit të përgjithshëm**

- i Ngarkesën më të madhe e ka Gjykata e Apelit Tiranë me 400 çështje për gjyqtar, ndërsa ajo e Korçës dhe Gjirokastrës kanë ngarkesë minimale.

**Gjykatat e Apeleve të juridiksionit të posaçëm**

- i Problematike paraqitet situata në Gjykatën e Apelit Administrativ, për të cilën propozohet gjithashtu t'i kërkohet Kryetarit së Gjykatës, në kushtet kur nuk është ngritur ILD ecila mbikqyr menyrën e ndarjes së çështjeve me short, informacon në lidhje me arsyet pse janë këto të dhëna;

**Në përmirësimin e kësaj situatë, propozohet veç plotësimin të vendeve vakante edhe miratimi i rregullave të detajuara për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short sipas pikës 3 të nenit 25 të Ligjit 96/2016;**

**Në lidhje me backlogun në Gjykatën e Lartë në shiftën 32 106 çështje propozohet marrja e masave paraprake nga KLGJ, të cilat do të ndihmojnë në shqyrtimin e sa më shumë çështjeve në momentin kur GJL do të jetë funksionale**

*Për çështjet e zvarritura tej afateve të arsyeshme të përcaktuara në nenin 399/2 të K.Pr.Civile, gjykatat që kanë një numër të madh të tyre, janë ; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me 547, ; Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me 7926 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me 398.*

Nga informacioni që jepet nga të gjitha gjykatat, arsytet të zvarritjes së çështjeve lidhen kryesisht me arsye procedurale siç janë; pezullimet, marrje provash, letërporosi, vendimmarrje nga Gjykata e Lartë, por edhe ngarkesa e çështjeve. Kjo e fundit lidhet me tepër me gjykatat administrative.

*b) Respektimi i etikës dhe solemnitetit nga trupa gjyqësore. Nga informacioni i ardhur nuk raportohet të ketë problematikë.*

*c) Numri i kërkesave për heqje dorë të miratuara nga kryetari i gjykatës për çdo gjyqtar si dhe të vendimeve për përjashtim gjyqtari të pranuar me kërkesë të palëve për shkak të konfliktit të interesit, bashkë me emrin e gjyqtarit të përjashtuar.*

Në lidhje me kërkesat për heqje dorë të gjyqtarëve dhe të pranuar nga kryetarët e gjykatave, konstatohet se ka një numër relativisht të madh të tyre. Shkaku i këtyre dorëheqjeve apo përjashtimeve evidentohet vetëm nga një pjesë e gjykatave, edhe pse sipas formularit të miratuar është kërkuar që të jepen shkaqet që lidhen me to.

Nga informacioni i ardhur vihet re një numër shumë i madh i kërkesave për heqje dorë të pranuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan me 232 kërkesa dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me 171 kërkesa. Arsyeja e këtij numri lidhet me një problem teknik që ka lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve, ICMIS që përdorin këto gjykata. Sipas shpjegimit të kryetarëve, ky sistem nuk i lejon të përjashtohen paraprakisht nga shorti i gjykimit të themelit të një çështje penale, gjyqtarin e hetimit paraprak të po kësaj çështje.

**Kjo e dhënë raporton përsëri për një problem të funksionimit të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, problematikë kjo e raportuar edhe më herët. Një pjesë e kësaj problematike mund të zgjidhet edhe nepermjet miratimit të rregullave të mënyrës së regjistrimit e ndarjes në short të çështjeve, p.sh duke shmangur automatikisht gjyqtarët e hetimit paraprak apo seancës paraprake nga gjykimi i themelit, që pa u hedhur çështja në short....etj.**

**Nga raportimet konstatohet se numri i vendimeve për pranimin e kërkesave për përjashtim gjyqtari është shumë i vogël në raport me kërkesat e pranuar për dorëheqje, në disa gjykata mungojnë teresisht vendimet për pranimin e kërkesave të palëve për përjashtim, me përjashtim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e cila raporton 2438 vendime për përjashtim gjyqtari. Nga të cilat 1060 vendime përjashtimi për gjyqtaren Atalanta Zeqiraj, kur numri i kërkesave të saj për të cilat është miratuar dorëheqja është 16. E njëjta situatë edhe për gjyqtaren Viola Canaj dhe Herila Cela respektivisht me 739 dhe 639 vendime pranimit kërkesa për përjashtim.**

Në kushtet kur KLGJ nuk ka kompetenca inspektimi sugjerohet t'i kërkohet Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, një informacion më i detajuar rreth situatës, sepse jo vetëm që ka mospërputhje të konsiderueshme midis heqjeve dore dhe vendimeve për pranimin e kërkesave për përjashtim për të njëjtin gjyqtar, por ka mospërputhje edhe me treguesit për gjyqtarët e tjerë të së njëjtës gjykatë. Rreferuar kritereve dhe treguesve të vlerësimit, numri i tejet i lartë i vendimeve për pranimin e kërkesave për përjashtim është

## **tregues i mungesës së kujdesit për të qenë i paanshëm.**

*d) Funksionimin e sistemit të regjistrimit audio dhe nivelin e përdorimit të tij nga secili gjyqtar. Paraqitjen në përqindje të numrit të seancave gjyqësore që regjistrohen në sistemin audio dhe shkaqeve për të cilat procesverbalet mbahen me mjete të tjera (kompjuter apo dorëshkrim). Evidentimin në përqindje të seancave gjyqësore të filluara me vonesë nga secili gjyqtar.*

Për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio, ashtu si edhe në tremujorin e parë, vihet re që ka diferenca të mëdha midis disa gjykatave. Në raportim nuk jepen shume shpjegime për arsyet e mospërdorimit por nga ajo që kuptohet shkaku kryesor i përqindjes së ulët së seancave të cilat regjistrohen nëpërmjet audios, është mungesa e sallave. Në lidhje me këtë situatë, ajo që sugjerohet është studimi i situatës në të gjitha gjykata dhe mundësia për të ndërhyrë me investime në gjykata që e kanë të theksuar këtë problem. Nga informacioni i përcjellë, konstatohet që gjykata me përqindjen më të ulët të përdorimit të sistemit të regjistrimit audio, është ajo e rrethit gjyqësor Tiranë, e cila është gjykata më e madhe në vend dhe që përballon ngarkesën më të madhe, në të cilën sugjerohet një ndërhyrje sa më e shpejtë për të investuar në përmirësimin e infrastrukturës së kësaj gjykate, me prioritet.

*Në lidhje me informacionin për fillimin e seancave me vonesë nuk raportohet problematike. Një pjesë e gjykatave që raportojnë disa vonesa japin edhe arsyet e këtyre vonesave, por që lidhen me shkaqe që nuk varen nga gjyqtarët, e që kanë të bëjnë kryesisht me faktin e zgjatjes së seancave pararendëse gjyqësore, vonesat e paraqitjes së palëve, shoqërim i të pandehurve, vonesat e avokatëve dhe prokurorëve.*

*e) Gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi.*

Përsa i përket përdorimit dhe problemeve të hasura në përdorimin e sistemit të administrimit të çështjeve, konstatohet se, pothuajse të gjithë gjykatat që përdorin sistemin ICMIS, parashtrajnë një sërë problemesh që hasin në përdorimin e tij, problematikë kjo jo e re por e njëjtë me atë të tremujorit të parë. Në këto kushte, sugjerohet që të shihet me prioritet ndryshimi i këtij sistemi dhe unifikimi për të gjithë gjykatat.

*f) Problematika të shfaqura në lidhje me vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara.*

Në lidhje me dorëzimin e dosjeve me vonesë, raportohet vetëm nga 19 Gjykata se ka raste të këtyre vonesave. Një pjesë e tyre shoqërohet edhe me shpjegimin e shkaqeve kryesore të këtyre vonesave, por nuk raportohet ndonje rast i cili të ketë sjellë pasoja për palët.

*g) Çdo problematikë tjetër të evidentuar e cila ka lidhje me veprimtarinë gjyqësore, si dhe sugjerimet përkatëse për zgjidhjen e tyre.*

Në lidhje me informacionin që kërkohet sipas shkronjës “g”, të vendimit, e që ka të bëjë me raportimin e çdo problematike tjetër të evidentuar, nga 38 Gjykata, 20 prej tyre kanë përcjellë disa probleme, të cilat janë të natyrave të ndryshme dhe të pasqyruara me hollësi në memon e sipërcituar. Ajo që vihet re nga tërësia e këtyre problemeve, është që zgjidhja e shumicës së tyre do të realizohet me hartën e re gjyqësore dhe që edhe për këtë arsye duhet ti jepet më shumë prioritet për ta përmbyllur sa më shpejt.

**Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale**

[Shqiptaria.com]